



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 28 Datë 13.06.07
PËR

MIRATIM FONDI PREJ 210.000 LEKË PËR FESTIVALIN E
MONODRAMËS "ALBAMONO 2007"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës për "MIRATIM FONDI PREJ 210.000 LEKË PËR FESTIVALIN E MONODRAMËS "ALBAMONO 2007", bazuar në Ligjin nr. 8652, Datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, germa "dh"; Ligjin Nr.8399, date 09.09.1998 "Per buxhetin lokal" Neni 6, Udhëzimin Nr.2 date 17.01.2007 te Ministrise se Financave "Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2007", VKB Nr.2 date 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve ne varesi per vitin 2007". V.K.M. nr 228 dt 13.04.2001 « Për dietat e nënpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre ». Udhëzimin Nr.353 date 19.03.2007 te Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve

VENDOSI

1.Të miratojë fondin prej 210.000 lekë për festivalin e monodramës « Albamono 2007 »

2. Ky fond do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të akomodimit si më poshtë :

Dieta

12 Persona x 5 dite x 2.000 lekë 120.000 lekë

Hotel

12 Persona x 5 ditë x 1.500 lekë 90.000 lekë

TOTALI 210.000 lekë

3. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet 00 04980 5 Art 6091100 - 210 000 leke

Shtohet 00 08250 5 Art 6020000 + 210 000 leke

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës ne Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE